



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. 06, datë 20.01.2024

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe”

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, germa a dhe c, nenin 27 pika 5, nenin 54 germa e/l, nenin 55 pika 3 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Pikën 49 të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; Ligjin 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik, **i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës _____._____2024 të :

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 2.02 ha **“Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje(kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj)”**, në ngastrën nr.108 të ekonomisë pyjore Gomsiqe, sipas plan rievimit, relacionit dhe studimit tekniko-ekonomik bashkëngjitur.
2. Afati i dhënies me qira të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

4. Ngarkohet për zbatimin e vendimit Drejtoria e Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit .
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr .139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Gjovalin Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 09 prot.

Vau Dejës, më 20.01.2024

RELACION

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplohëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e(l), neni 18 pika 2 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

Sipërfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do ti nështrohet procedurës së konkurrimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Sipërfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 2.02 ha, në Ekonominë Pyjore Gomsiqe.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, Shtojca

1, pika 6/1, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit si më poshtë:

6.Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj				
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqja e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
		1 vit	2- 5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll Trungishte	198000	132825	110000
2	Pyll cungishte	138600	99000	82500
3	Pyll shkurre	138600	99000	82500
4	Kullota	138600	99000	82500
5	Tokë me Bimësi pyjore, djerr	99000	57200	49500
6	Inproduktive	99000	57200	49500

Afati i dhënies me qira do të jetë deri ne 9 vjet.

- Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik është 222,200 lekë në vit** (Dyqind e njëzete e dy mijë e dyqind) lekë
- Sipas VKM-së nr 748, datë 01.12.2022** “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë të brigjeve të burimeve ujore”, siperfaqja që do jepet në përdorim ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5:Në liqene, rezervuarë, pellgje me ujë, natyrorë apo artificialë, laguna, zona dhe gjerësia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujqor.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet, të sipërfaqes prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojtrash,mjedise sportive,shplodhëse,kulturore, etj), në ekonominë pyjore Gomsiqe.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë.

1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punës


Ing.Mark Suli



**Miratoi
Drejtori
Vehbi Shkjau**



Ing.Zeqir Ujka



Bashkia Vau Dejës *Shtojca nr. 1*

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKETË BASHKISË VAU DEJËS

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe”

Bazuar në Urdhërin nr. 36, datë 16.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë “Për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënien me qira sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe”. Grupi i punës i përbërë nga z.Zeqir Ujka përgjegjës i sektorit të pyjeve, z.Mark Suli, specialist i menaxhimit të pyjeve ,nga data 16/01/2024 deri në datën 17/01/2024 realizoi studimin tekniko-ekonomik, verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes pyjore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore 2.02 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj).

Mbështetur në të dhënat e regjistrin kadastral pyjor/kullosor sipas VKM-së nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive” i ndryshuar, rezulton që sipërfaqja e propozuar për tu dhënë me qira është 2.02 ha dhe bën pjese në ngastren nr.108 , ekonomia pyjore Gomsiqe, sipas listës së inventarit, shtojca nr.47, janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: (sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).

Ndërhyrjet e propozuara do të jepen në përdorim për një afat deri në 9 vjet për sipërfaqen pyjore prej **2.02 ha** për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj).
Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullësor publik janë të mbështetura në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", ligjin nr 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullësor", i ndryshuar, udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik" pika nr 2 germa (a) dhe pika 7.

Sipërfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do ti nënshtrohet procedurës së Konkurrimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkisë nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumentave përkatëse të konkurrimit dhe zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullësor bazohen në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca 1, pika pika 6/1, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lekë/vit konsiston në:

1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)

1. Ngastra nr .108 **trungishte 2.02** ha x 110,000 lekë/ha = **222,200** lekë në vit (Dyqind e njëzetë e dy mijë e dyqind) lekë ne vit.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Gjovalin Zefi



PERGATITI:

Data Pergatitjes: 12.03.2024

SIPERFAQE

S= 2.0202 Ha

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE GOMSIQE

NR.PASURISE 108-S1 VOL _____ FQ _____

SHKALLA 1:10000


INDEKSI I HARTES Ekonomia PYJORE GOMSIQE

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER F: _

POROSITES : BASHKIA VAU DEJES



SISTEMI I KOORDINATAVE: GAUS KRYGER



KOORDINATAT E KONTURIT:

- | | | | |
|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| 1) X= 4654493.3
Y= 4388773.3 | 2) X= 4654478.2
Y= 4388839.2 | 3) X= 4654487.5
Y= 4388884.7 | 4) X= 4654320.2
Y= 4388844.4 |
| 5) X= 4654332.9
Y= 4388717.7 | 6) X= 4654400.0
Y= 4388742.9 | 7) X= 4654415.3
Y= 4388725.2 | |

Gjyq. Mark Suli